



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.46, datë 28.09.2007

**“MBI MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, PËR TË CILAT BASHKIA E TIRANËS KËRKON TRANSFERIMIN
NË PRONËSI TË SAJ”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 8/II/a/c, Ligjin Nr.8743, dt.22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", Ligjin Nr.8744, dt.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore", V.K.M. Nr.500, dt.14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimit Nr.3 dt.18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimit Nr. 15, dt.30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike", pika 1/a, me propozim të Kryetari të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin e Listës paraprake të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, të ndodhura në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës me numër total 5775, (sipas listës bashkëlidhur).
2. Përcjelljen e listës paraprake të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, të ndodhura në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës, për miratim pranë Këshillit të Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve (Sektori i Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme).
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R

